



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:230728

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06585251

KPPP.nr.1729/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arben Toska, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Komuna e Prishtinës” me seli në rrugën UÇK nr.2 në Prishtinë, kundër debitorit “Xhambazi Pharm” OP me NUI 810895401 dhe seli në rrugën Gazmend Zajmi nr.93 në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor, jashtë seancës më 29 nëntor 2024, mori këtë:

AKTVENDIM

Pranohet në tërësi prapësimi i debitorit “Xhambazi Pharm” OP me NUI 810895401 dhe seli në Prishtinë, anulohet në tërësi urdhri përmbartimor P.nr.394/2023 i datës 17.08.2023 i përmbartuesit privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë dhe përfundohet në tërësi procedura përmbartimore.

ARSYETIM

Kreditori më 16.08.2023 ka parashtruar propozim për përmbartim (këtu e tutje Propozimi) në zyrën e përmbartuesit privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë (këtu e tutje Përmbartuesi), me të cilin ka kërkuar që të detyrohet Debitori që t’ia paguaj shumën prej 750.00€ si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim e kishte bazuar në faturën nr. 201912782 të datës 20.12.2022 të lëshuara nga ai për Debitorin, të cilat në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit.

Përmbartuesi më 17.08.2023 e ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.394/2023 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbartimin sipas Propozimit (këtu e tutje Urdhri).

Debitori më 13.10.2023 ka parashtruar prapësim (këtu e tutje Prapësimi) duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i kërkuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin dhe ta anuloj urdhrin. Ai ka pretenduar se taksa e supozuar si ngarkesë për bizneset për të cilën është ngarkuar debitori është pa efekt juridik për faktin se kjo lloj takse nuk aplikohet në të gjitha bizneset e fushës

farmaceutike. Thekson se kjo taksë nuk evidentohet fare në ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarive afariste e bënë të pa ekzekutueshëm këtë propozim për përmbarrim ashtu siç përcaktohen në nenin 71 të LPP-së. Ka shtuar se Kreditori nuk i ngarkon me këto taksa bizneset afariste në fushën farmaceutike që janë të hapur pas vitit 2014 ngase kjo periudhë në vazhdim Ministria e Shëndetësisë nuk e kërkon lejen e komunave, prandaj sa për ilustrim biznesi afarist në fushën farmaceutike “Xhambazi Group” ShPK me NUI 810843385 dhe seli në Prishtinë, asnjëherë nuk është ngarkuar me këtë taksë. Prapësimit nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimit.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi atë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin dhe të vërtetohet urdhri për përmbarrim. Ai ka deklaruar se në bazë të fakteve të paraqitura në kundërshtimin e Debitorit shihet qartë se asnjëra nuk paraqet bazë për kundërshtim konform dispozitave të nënti 71 të LPP-së. Ka theksuar se lidhur me pretendimin e Debitorit se janë plotësuar kushtet nga neni 61 par.1.1 të LPP-së për të goditur urdhrin për përmbarrim, Kreditori e njofton gjykatën se dokumenti përmbarrues i nxjerr në procedurë administrative /kundërvajtje, në përputhje me nenin 24.4 të LPP-së është i përmbarrueshëm sipas rregullave me të cilin rregullohet kjo procedurë, konkretisht neni 30.4 të Ligjit për Kundërvajtje. Përgjigjes në prapësim nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë, nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të Debitorëve të paraqitura në Prapësim dhe deklarimeve të Kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se prapësimi është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Kreditori i ka lëshuar Debitorit faturën lëndore në emër të ngarkesës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste, të cilën në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit. Ajo përmban të dhëna për Kreditorin dhe Debitorin, numrin e faturës, datën e faturimit, shumën, objektin, llojin dhe kohën e përmbushjes së detyrimit monetar.

Gjykata gjen se në faturën lëndore mungon nënshkrimi dhe vula e Debitorit. Në shkresa të lëndës nuk ka prova se Debitori në ndonjë formë e ka pranuar faturën lëndore.

Situata e lartcekur rregullohet në rend të parë me nenin 29 të LPP-së, i cili në para. 1 nënpara. 3 ka rregulluar se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është (...) 1.3 faturat”* ndërsa në para. 3 ka paraparë se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Siç u sqaruar edhe më lartë, fatura lëndore nuk është pranuar nga Debitori, meqenëse në atë nuk gjendet as nënshkrimi e as vula e Debitorit, si dhe nuk ka prova se ai e ka pranuar faturën lëndore dhe detyrimin që rrjedh nga ajo, rrjedhimisht fatura lëndore rezulton të jetë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga Kreditorit, dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbaerim. Si rezultat i mos pranimit kësaj fature, vjen deri te mungesa e tipareve të përmbaerueshmërisë së dokumentit të besueshëm, rrjedhimisht duhet të zbatohet neni 71 para. 1 nënpara. 1.1 të LPP-së, sipas të cilit “(...) *prapësimi mund të bazohen vetëm nëse dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbaerues ose urdhri përmbaerues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbaerueshmërisë*”. Për gjykatën, mungesa e lartcekura në dokumentin e besueshëm paraqet pengesë të pakapërcyeshme ligjore, rrjedhimisht nuk mund të lejohet përmbaerimi, prandaj e anuloi Urdhrin. Meqenëse nuk kishte çështje tjetër për tu trajnuar, gjykata e përfundoi procedurën si në pikën dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sa i përket pretendimit të Kreditorit se dokumenti i nxjerr në procedurën administrative/kundërvajtje në përputhje me nenin 24.4 të LPP-së është i përmbaerueshëm, gjykata vëren se Kreditori procedurën përmbaerimore e ka filluar duke u bazuar në faturën lëndore, pra dokumentin e besueshëm, e jo në ndonjë akt administrativ. Për këtë arsye, gjykata e pati juridikisht të pamundshme që të lëshohet në përshtatshmërinë e përmbaerimit të ndonjë akti administrativ për caktimin e taksave komunale.

Gjykata i mori parasysh edhe pretendimet tjera të Debitorit dhe Kreditorit, por ato nuk ishin të rëndësishme për të vendosur ndryshe nga dispozitivi i këtij aktvendimi.

Përveç kësaj, gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerësoi se nuk është e domosdoshme të caktohet seancën gjyqësore për ta kuptuar plotësisht validitein e Prapësimi, siç ka caktuar neni 73 para. 1 i LPP-së, meqë në bazë të këtyre shkresave gjendja faktike dhe juridike ishte qartë.

Për këto arsye, në kuptim të nenit 71 dhe 73 para. 3 të LPP-së lidhur me nenin 13 para.1 nën para. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1729/2023

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese ndaj këtij aktvendimi brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.